

INTERVISTË ME GANI OSMANIN

Stantërg | Data: 26 tetor, 2020

Kohëzgjatja: 93 minuta

Të pranishëm:

1. Gani Osmani (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Gani, nëse mundeni me na jep një prezantim për veten edhe me na tregu diçka prej çfarë familje vini?

Gani Osmani: Përshëndetje për juve, une jom Gani Osmani, i lindun me 17. 4. 1962-tën, kom lind në fshatin Dedi osht' një fshat këtu në periferi të Stantërgut të "Trepçës", domethonë i ka një dhetë kilometra prej Stantërgut. Baba im ka punue edhe mixhallarët e mi kanë punu në minierën e Stantërgut, domethonë prej viteve të '60-ta dikun, të inkuadrum. Edhe kështu familja jonë ka qenë një familje kështu e varfun si të gjithë, krejt jonë varë prej "Trepçës", domethonë pi minierës, prej kësaj miniere. Në vitet '64-'65 na kena dalë prej fshatit Dedi në një periferi të Mitrovicës, në fshatin Shipol, osht' lagje e Mitrovicës. Aty e kena ndërtu shpinë edhe kena jetu prej vitit 1965.

Na jena kanë pesë fëmijë, baba i ka pasë pesë fëmijë, domethonë i ka pasë dy djem edhe tri, tri vajza. Unë kam qenë djali i dytë, nejse një motër, tani kam qenë unë edhe një vlla edhe dy motra masnej. Shkollën e kom kry në Shipol, shkollën fillore. Të mesmen e kom kry Shkollën Teknike në Mitrovicë, domethonë teknik i xehëtarisë, drejtimin e xehëtarisë. Meqenëse familja jonë edhe rrethi i Mitrovicës ma shumë janë varë prej "Trepçës", janë shku në drejtim... prindët tonë i kanë çu në qat' drejtim. Domethonë, për me ardhë ma shpejtë dej te puna edhe për mu inkuadru për ma shpejtë. Une e kom kry shkollën në vitin 1981, vitin e katërt, e kom krye në maj 1981, në dhetin muj domethonë tetor 1981, jom inkuadru. Domethonë, jom kon në moshën 19 vjeçare.

Une e kom pasë edhe ni përparësi pak, po tregoj kështu, m'u inkuadru në punë se prindi jem në vitet e '60-ta ka qenë i lëndum këtu në minierë edhe për atë shkak ka qenë edhe një lloj përparësie. Domethonë, mbi moshën... si teknik i xehëtarisë e kom fjalën, atëherë teknik ka pasë... mbikëqyrësa edhe teknik në vitin '81 ka pasë pak, ma shumë ka pasë sërbe. Domethonë, në vendet kyçe ku jonë kanë strukturat, jonë kanë sërbe. E [shqiptarë] ma shumë ka pasë punëtorë të thjeshtë edhe tjera lamive. Në vitin '81 na jena hi me konkurs 24 teknik të xehëtarisë, shokë që jena kanë në shkollë. Nejse,

do jonë konë gjenerata ma të moçme që e kanë kry shkollën, mirëpo nja tre a katër që i majë në mend une shokë të mi, domethonë jonë hi në moshën 19 vjeçare. Edhe ata e kanë pasë një përparësi, atëherë u konë përparësi ju ka lëndu prindi ose i ka dekë, ose... edhe jonë inkuadru pa kushte.

Anita Susuri: Deshta, deshta m'u kthy pak te baba i juj që ka punu në "Trepçe"...

Gani Osmani: Po.

Anita Susuri: Edhe osht' lëndu, a e mbani në mend ju si fëmi kur jeni konë kur vike prej punës ose në çfarë gjendje, ose a tregojke najsen ai për punën?

Gani Osmani: Shiqo une e majë në mend, prej pune nuk e majë në mend se ai... une dikun jom konë shumë i vogël në vitin... diku pesë, gjashtë vjeçar tash s'po jom shumë i sigurt, dikun në vitet '69 ose qaty dikun u lëndu ai. Domethonë, unë e majë në mend veç kur u lëndue, a din kështu më kujtohet, se ai ka nejt dikun gjashtë muj, ka nejt në spital të Shkupit. Tani, nejse, ka nejt në shpi edhe kështu atëherë e di që kushtet i kanë pas ëshumë të vështira se me një rrogë e ka ble trollin në Shipol, ka maru shpinë, na ka shkollu, domethonë këtu jonë konë kushtet shumë... Rrogat nashta jonë konë të mira, mirëpo tash po tregoj kushtet e vështira i ka pasë.

Veç më kujtohet kur ka qenë i lëndum e më kujtohet që e ka pas komën në gips edhe neise, masanena u shëru, ka punu një kohë si invalid masi, masi u shëru ka punu një kohë si invalid i punës. Atëherë i kanë pas rrogat ma të mira invalidë. E ka pas rrogën sikur punëtorët që kanë punu se u konë edhe sigurimi, ky sociali na qysh i kena thonë, i ka siguru edhe i ka siguru një pjesë "Trepça", domethonë me qato, me qat' pagë ka ble tokë, ka maru shpi, na ka shkollu. Edhe qysh tregova në vitin '81 jom punësu unë, në vitin '84 u punësu edhe vllau i jemi, edhe ai u konë si, si, si... makinat gdhendëse që i gdhendin metalet, edhe ajo o njësi e "Trepçës", ka punu edhe në fabrikë të procesit të pajimeve. Domethonë, e kena pasë një lloj përparësie.

Anita Susuri: Po ju ndërprej edhe një herë se po më intereson shumë qysh u lëndu baba yt?

Gani Osmani: Baba jem ka qenë drejtëpërdrejtë minator, jo minator po ndihmës-xehëtar. Domethonë, xehëtari është mjeshtri kryesor ai që punon, çpon me makinë edhe e rrxon xehen, e baba jem ka qenë ndihmës i tina. Mirëpo, një kohë shumë... diku 5-6 vjet nuk ka punu ma shumë, ai është lëndu. Po aty lun pak rol edhe fati, fati për shembull, ka njëri që ka punu, unë e di shokë të mi, kanë punu 40 vjet, kurrë su lëndu. Ka njëri për një vjet u lëndu me fatalitet ose... domethonë shumë lun rol fati. E ai u lëndu në vend të punës, në ngjarje, drejtëpërdrejt i kanë ra {shikon lart} bllokat, na ju thojmë blloka këtyne gurëve që janë pjesa tavanore, ajo bohet çamja me eksploziv, tana jetë nashta e kacavirrun edhe fati kush shkon e nxen.

Domethonë, ai e ka pasë të lëndum kurrizin edhe e ka pasë komën e thyme edhe nejse një kohë në spital atëherë u konë. Spitali i Shkupit, i kanë çu nëpër Ljublanë e nëpër Beograd, e nëpër Shkup, domethonë për mjekësi s'ka pasë problem në atë kohë i kanë shëru krejt pa, pa pare. Edhe qajo u konë pak përparësia. Tash mas... thashë edhe ma herët kur jom konë i ri nuk më kujtohet, kur u ardh prej pune, ka shku në punë s'um kujtohet. Domethonë, se nashta jom konë tri-katër vjeç e nuk më kujtohet. Veç më kujtohen ato, ato kur ka ardhë prej spitali, kur janë ardhë njerëzit me i pa, domethonë qato gjana më kujtohen.

Edhe kur jom hi në punë '81-tën pak, pak u zbut situata kështu ekonomike a din, pak si i ri, unë jom hi shumë i ri edhe jom hi drejtëpërdrejt teknik i xehëtarisë. Mirëpo, na kena punu edhe kur jom hi në atë kohë u konë një rregullore që e patën pru këta drejtorat edhe që je teknik i xehëtarisë si mbikëqyrës, domethonë, tekniku i xehëtarisë e kryen punën e mbikëqyrësit, krejt horizontin e ka përsipër e udhëheqë punën, i shkrun meditet. Por, ni vjet e kena pasë praktikë, domethonë ni vjet e ke pasë me punu makinë, ni vjet me i grah mjeteve tjera të punës pa marrë parasysh a o llokomotivë. Mas ni vjet që e kryen praktikën ti ke pasë me hi në provim edhe me jep provimin, ni provim prej këtyre inzhinjerav, drejtorav.

Anita Susuri: A ke pasë edhe si bursë të shkollës mesme?

Gani Osmani: Jo une bursë nuk kom pasë, kanë pasë, kanë pasë tjerët bursë, ka ndodhë që kanë pasë. Mirëpo, une bursë nuk kom pasë. Aty u konë edhe një lloj përparësie edhe bursë kush ka pasë, se ata njerëzit që kanë pasë bursa... unë e di shokë kam pasë që ka pasë bursë, i ka pasë kushtet e vështira, domethonë kur e ka pasë atë bursën ka pasë përparësi me hi në punë. Mirëpo, unë nuk kam pasë bursë, tash nuk e di pse, nashta baba atëherë u konë në punë, kushtet pak ma, a din, edhe... Po tash kur u lëndu baba, tani unë mas ni kohë, mas nja dhetë-pesëmdhetë vjete jom hi në punë se jom konë shumë i vogël. Domethonë, qat' përparësi e kemi pasë.

Që kesh t'u tregu tani, unë e kom kry praktikën, kena punu për me njoft punën në minierë, jena hi në provim e kena kry qat' provimin edhe unë kom vazhdu prej '82-tës me punu si teknik i xehëtarisë. Kom punu nëpër horizonte të gjitha, ma së pari kom punu në horizontin e pestë edhe atëherë jom konë aktiv në dhetë horizontet, nontë jonë konë kur jom hi unë. Prej të parit horizont deri në horizontin e nontë, gjithë kanë pasë punëtor, të gjithë kanë punu. Domethonë, u konë numri i madh i punëtorëve atëherë, më kujtohet ka pasë edhe punëtorë të vjetër. Mirëpo, në atë kohë, në atë kohë jonë dalë me punëtorë që kanë punu në minierë e kanë pasë na i thojmë stazhin ose përvojë me benefit. Domethonë, e ka pasë policia, në shtet që osht' shteti i fortë, aviacioni edhe minierat e kanë njejtë.

Minatorët drejtëpërdrejtë që kanë qenë t'u punu në minierë atje në ballë të punës e ka pasë dymdhetë muj-tetëmdhetë Domethonë, dymdhetë muj ka punu, një vjet ka punu, një vjet e gjys ju ka shkru. E atëherë janë dalë me 40 vjet përvojë pune. Unë e di pa u bo 50 vjeçar, une që jom hi në moshën 19

vjeçare dikun pa i bo 50, 47-48 vjet u duft me dalë në penzion. A din, u konë qajo. A tash, tash e kije deri në moshën 65 vjeçare pa marrë parasysht.

Anita Susuri: Ti kur ke hi në punë '81-tën...

Gani Osmani: '81-tën.

Anita Susuri: U konë një situatë pak e sikletshme...

Gani Osmani: Po shumë. Une...

Anita Susuri: Jonë konë edhe demonstratat mos keni marrë pjesë...

Gani Osmani: Po, na jena konë, mu më kujtohet fortë mirë, une në vit të katërt jom konë maturant, na jena konë të ri, normal. Atëherë demonstratat që jonë organizu ka pasë edhe në Mitrovicë edhe në Prishtinë edhe krejt. Na jena dalë prej shkollës më kujtohet fortë mirë, prej shkollës teknikës se une kam qenë në shkollë të teknikës, atëherë gjimnazi edhe teknika m'u bashkue me protestu. Mirëpo, neve policia na ka ndalu në rrugë aty te shkolla e teknikës që osht', te ai udhëkryqi edhe nuk na kanë lonë me dalë knena me shku prej gjimnazit, po me shku... na kanë shpartallu shkurt e shqip domethonë me armë e me kësi.

Edhe në qat' kohë bash ni kusheri i jemi o që ka vdekë, në '81-tën u myt në Sitnicë. Osht' Sinan Bajrami, domethonë ai ka qenë në vitin e tretë, na kena qenë në vitin e katërt. Edhe kur kena dalë na, kur kena dalë na, na kanë njëk anena, na u kthym ka Dudikrshi osht' ajo ura atje, u konë një urë e ngushtë me dal atje te Dudikrshi {me kokë tregon majtas} se qashtu na kanë njëk. Edhe ai ka tentu, s'ka mujt me hi në urë atje, po u ikë, ka tentu me ikë edhe u hi në ujë aty edhe u myt në ujë. Nejse, sot osht' data që ka vdekë në demonstrata të '81-tës, që ka dalë prej shkollës.

Atëherë edhe situata politike u konë shumë, shumë e ndërlikume, u konë e rrezikshme besa. Tash u duft me punu, në politikë s'ke mujt me ju përzi. Ka ndodhë që na kanë marrë edhe mu vet në pyetje më kanë marrë. Janë shkru parullat nëpër minierë, i kanë shkru "Kosova Republikë", atëherë qajo parullë u konë, e tani u shku ja ka marrë mendja, nashta veç e ka shkru filani, filani. Ma shumë i kanë marrë djemtë e ri që i kanë pytë, "Kush i ka çkru, pse i ka çkru?" Tani une në vitin '81, '83, në janar '83-tën kom shku ushtar, se e kom pasë ushtrinë pa kry. Jom shku në Kroaci, jom konë në periferi të Zagrebit edhe atje kena pasë malltretime, kena pasë në pyetje, domethonë gjithçka ju ka interesue shtetit atëherë. U konë shumë vështirë, u konë shumë vështirë me punu. Edhe...

Anita Susuri: A je frigu atëherë kur e ke ditë që po shkon në ushtri, atëherë ka pasë edhe shumë... domethonë që janë vra në ushtri...

Gani Osmani: Po, unë e di që...

Anita Susuri: A ka qenë najfarë frige, a çka ke menu ti?

Gani Osmani: Po sigurisht. Kur jena shku na ushtarë që kena shku, familja edhe ka qajt. Se tash je shku, tash u varë edhe krejt çfarë veni je ra. Ata të sigurimit çfare jonë konë, nashta hiç pa kurrfarë faji të ka akuzue veç që je konë halë në sy. Une, mu më kujtohet, na ja dijmë edhe nderën, u konë një shok, u konë një shok i Podujevës ma i vjetër se na, na jena konë të ri do, ka pasë edhe ma të ri se unë shumë. U konë një shok i Podujevës, ai u konë ma i vjetër, na i majke do farë... na thojkë që, “Duhet m’u rujt, mos me fol gjithçka se bjen viktimë pa kurrigjo”. Edhe u duft m’u rujt pak, ka ndodhë që dikush nashta s’ka ditë mu rujt e u shu shumë i kanë marrë edhe në pyetje, pak pa e kry ushtrinë, një muj dy pa e kry e kanë marrë në pyetje ata të sigurimit, “Jo ke thonë kështu, jo ke bo kështu, jo je konë në demonstratë”. I kanë çu ka pesë-gjashtë vjet burg, do s’jonë kthy hiç, ka plot që s’jonë kthy hiç. Domethonë, u konë, u konë kohë shumë e vështirë.

Anita Susuri: E çka s’keni guxu me fol, për shembull çkado qoftë diçka për Kosovën Republikë, a çka?

Gani Osmani: Po aty çka ke fol për shtet, për drejtë tone ti je konë kundër Sërbisë. Domethonë, ti drejtat tua ç’a ti lypsh ti je konë... nashta kanë dashtë minatorët me lyp edhe kushte s’ka guxu se i ka thonë çashtje politike. Domethonë, republikën s’ke guxu me përmend, të drejtat tua s’ke... për shembull, për shiptarë, të drejtat e shiptarëve i keni ju... sigurimi u konë në pyetje. Unë e di masanej kom punu si mbikëqyrës edhe ni defekt m’u bo diçka në minierë meniherë të vetke, mu, “Kush u konë, kush e ka prish mjetin, a e ka nalë punën me qëllim a jo? Pse u prish, në sa ora u prish, a u konë në rregull?” E ka marrë edhe atë punëtorin që u konë aty e ka marrë në pyetje. Domethonë, u konë kjo, qysh me thonë, rrezhim i hekurt u konë që veç u dufshim m’u rujt se, se nashta me pasoja krejt.

Anita Susuri: A ju kanë marrë shpesh në bisedë informative?

Gani Osmani: Këtu?

Anita Susuri: Sa jeni konë në ushtri?

Gani Osmani: Në ushtri, po. Na merrke neve njo, na i thojshim i sigurimit, ata jonë konë të sigurimit. Edhe tash ai veç kujna ju teke. Shqiptarët i kanë marrë ku jom kon une të gjithë. Mirëpo, atëherë edhe me pasë pak shkollë të kryme je konë ma, ma halë në sy. Ata që jonë konë me fakultet, që e kanë pasë fakulltetin jonë konë intelektual, ata i kanë marrë ma shumë edhe i kanë dënu ma shumë. Domethonë, këta njerëzit që janë ma të thjeshtë, ma pak domethonë. Atyne ju ka pengu shkollimi edhe përparimi shiptarëve, domethonë qysh e kena pa na. Ata që jonë konë të shkollum ka qenë ma, ma rrezik për ta. Tani, nejse, unë e kom kry ushtrinë, mandej apet mas ushtrieje jom ardhë e kom vazhdu punën. Masanej...

Anita Susuri: Cilin vit e ke kry?

Gani Osmani: '84-tën jom shku ushtar në janar, dikun në katërtin muj, pestin '85-tën jom ardhë. Domethonë, prej '81 deri '84, tri vjet kom punu, jom shku ushtar. Tanaj jom ardh e kom vazhdu apet punën se atëherë u konë qashtu që ke vazhdu punën. Domethonë, qato vitet, gjenerata jonë, gjenerata jonë... unë jom '62-sh tash, '81-sh na jena kon maturanta, gjenerata jonë osht', gjenerata ma e keqe që... jo e keqe gjenerata, po koha ma e keqe. Domethonë, na as mramje të maturës nuk kena mujt me bo. Jena konë gjithë... demonstratat që jonë konë, protesta, tani këto protestat që jonë ardhë dej në '89-tën. Domethonë, kurrë nuk jena konë të lirë, as s'jena konë të knaqun veç gjithë me vujtje, me tutë, me papunësi, me fukarallëk. Domethonë, gjenerata jonë u konë, qajo gjeneratë që, që gjo të mirë s'ka përjetu.

Anita Susuri: Deshta edhe me u ndërlidh qitu, mas '81-tës e di që u konë pak problem edhe kur kanë pa ma shumë grupe të rive që kanë nejt bashkë.

Gani Osmani: Po.

Anita Susuri: A të ka ndodhë najherë që ka ardhë policia nëse me shokë ke nejt, ose...

Gani Osmani: Po mas '81-tës, atëherë gati, gati gjithë ka qenë orë policore. Domethonë, na në punë kur kena ardhë... unë kom punu me ndërrime në atë kohë, ka ndodh dy-tri herë dej jena ardhë te autobusi na ka nalë njësia speciale. Po na i kena pasë do, i kena pasë do letra që na i kanë dhonë këtu, do dokumente që munëm me qarkullu. Mirëpo, si të është orë policore ty nuk të len as me qarkullu domethonë. Atëherë ka pasë policë boll edhe ka vesh policë rezervë. S'ka pasë skutë, as rrugë që s'ka pasë policë, ditën-natën.

Ka ndodhë nashta ka qenë i pijtë [polici], të ka rreh pa sen në dynje t'u ardh në punë, s'të ka vet hiç. Na e dimë që... shokun për shembull e ka rreh, hiç s'e ka vet, veç e ka nxon ora policore edhe dokument s'i ka lyp. Domethonë, atëherë orë policore prej '81-tës e teknena, një kohë bile '81-tën ka qenë ora policore gjithë. Ka qenë rrezik, ke mujt me hup jetën veç që i teket dikujna. Domethonë, veç që je shiptarë.

Anita Susuri: A ka pasë naj organizim shoqnor a diçka, me dalë a najsen, a u konë edhe për ato e ndalume?

Gani Osmani: Qysh po mendon, për...?

Anita Susuri: Me dalë për shembull, shoqnia me u mledhë?

Gani Osmani: E une, na kur e kena kry vitin e katërt, s'kena mujt me bo mramjen e maturës. Na i kena do foto që kena dalë me do shokë, po jo numër shumë... se edhe nuk guxojshin. Jena dalë me ni pjesë të Shalës knej thirrët Preten, në fusha, qaty e kena festue këto, domethonë që e kena kry vitin e katërt, si mramje maturës. Kena nejt pak, jena mledhë shokët, se nuk ke pasë shanca edhe me dashtë me organizu, nuk ke pasë, nuk ke pasë shanca.

Korab Krasniqi: A jeni i martum zoti Gani?

Gani Osmani: Po. Une jom i martum, i kom, i kom pesë, vajza edhe ni djalë, se nashta nuk tregova ma herët. Edhe i kom tri vajza të martume edhe djalin. Djalin edhe vajzën e kom në Gjermani edhe ata kanë fëmi, djali i ka tre fëmi edhe këto vajzat që i kom kanë fëmijë të gjitha, kanë djem edhe vajza. Dy vajza i kom te shpia në shkollë jonë, nejse e kanë kry. Njona osht' në shkollë, njona o në fakultet, ma të vogla. Domethonë, i kom pesë, pesë fëmijë, tash jon kushtet ma të mira se kur kom qenë une fëmi. Se kur kom qenë une fëmi, ma parë prindët tonë nashta edhe nuk jonë kon krejt, krejt kështu, po edhe thojshin nifarë fjale, me ju dhonë fëmive pare prishen. A din, ja del knej, ja asi... Tash masi vet kena hjek, une fëmive të mi, jom munu kështu mos m'i lonë, bile vajzat mos m'i lonë kurrë pa pare. Nashta s'kom... një kohë qat' kohën që jena konë ma të ri jena konë pa punë, mirëpo në përgjithësi jena munu me ja bo pak, me ja bo pak kushtet, tash jonë bo kushtet pak ma të mira domethonë.

Korab Krasniqi: Sa vjeçar je konë kur je martu?

Gani Osmani: Unë jom konë 26 vjeçar.

Korab Krasniqi: A po na kallxon qysh e ke njoft grun tone?

Gani Osmani: Po, atëherë ka qenë pak ma, ma ndrysh, mirëpo une e kom njoft... nejse, lidhje mas lidhje, e kom pa kështu, kemi bisedu me to edhe me msit atëherë u konë. Normal...

Anita Susuri: Deshta me ju pyt qitu se po më intereson shumë, e dimë që e minatorit puna është shumë e rondë...

Gani Osmani: Po.

Anita Susuri: Edhe tashti a ka pasë njëfarë... a kanë ngurru për shembull familjet ose femrat për m'u martu me minatorë?

Gani Osmani: Shiqo, baba i asaj shoqes tem ka punu këtu në "Trepçe" edhe tash une me këta, një punëtor që e kom pasë e ka pasë mesë atë grunë tem edhe qashtu lidhja mas lidhjes. Mirëpo, atëherë m'u konë në punë edhe me pasë pak titullin ma të naltë nuk kanë pritu fort, se u konë problem edhe m'u konë në punë edhe tregova ma pare, me konë në vend udhëheqës pak... ka pasë shumë pak

shiptarë edhe në qat' farë mënyre nuk kanë, nuk kanë pritu shumë. Domethonë, ne jse jonë kanë edhe me marrëveshje me shoqën që e kom une, normal aty kejt m'u pajtu kur s'pajtohen këta dytë, nuk pajtohet kërkush. Veç une kom kalu mirë, ni familje të mirë kështu, me fëmijë, me krejt edhe me prind kom kalu shumë mirë domethonë. Kryesore çka osht' u kanë një jetë kështu e mirë, pa probleme, pa telashe me familje, me... E për këto sa kena pas, qaty sa kena pas edhe kena hongër, kena pi. Kryesore mu kanë jeta e lumtun, me pas fëmijë edhe qashtu.

Anita Susuri: A e keni ni najherë bashkëshortën që ju ka anku për qet' punë, edhe që po shqetësohet? A u shqetësu, a ju ka tregu najherë?

Gani Osmani: Po, normal. Jo veç shoqja, po edhe, edhe baba, e nona, e motrat kur jom kanë pa martue. Nji kohë na si jena vanu pak, atëherë s'ka pasë telefona. Menihere, ose kanë shku në koshji një ndërrim që jena kanë me to, ose ka bo pyetje dikun, "Pse u vanu, pse s'erdh?" Domethonë, tanaj edhe shoqja normal se kur kena punu me ndërrime, kena shku në ndërrim të parë, ndërrim dytë, ndërrim tretë. Tash duhet me ditë që në ndërrimin e tretë në ora shtatë na jena dalë, në gjys tetë-tetë ma së largti duhet m'u kanë te shpia. Ose kom pasë une me shku dikun, me naj shoqni, na ju kem tregu, "Nesra vanona". Po puna e minierës e ka qasi, qasi soji që si të vanohesh shkon menja e keqe meniherë, mos u lëndu, mos u vra.

Bile ni mixhë i jemi që e kom pasë, ai kurrë nuk vetke a je lodh, veç thojke, "A jeni dalë tetonë shnosh?" "Po", "Qaq". I thojshim, "Pse mixhë s'po na thue a je lodh?" Thojke, "Kryesorja me dalë gjithë shnosh e tani me pushue, edhe që je lodh pushon". Domethonë, puna e minierës i ka do specifika edhe osht' pak ma e veçantë edhe osht' rreziku ma i madh. Domethonë, qe edhe flamuri {shikon në anën e djathtë} kjo e ka ngjyrën e zezë, ngjyra e zezë e ka ni domethonje, domethonë 50/50 osht'. Ngjyra e gjelbërt edhe e zeza, domethonë kjo osht', osht' bukë që fitohet... një numër i vogël e fiton nën tokë. Të gjithë e fitojnë bukën mbi tokë, na e fitojmë nën tokë. Domethonë, osht' pak ma veçantë, ma, ma e zorshme. Mirëpo, dikush duhet me punu edhe e kena zgjedhë profesionin qasi soji që duhet me punue domethonë.

Anita Susuri: Domethonë, që ka punu baba jot e ke ditë edhe ke vendos qashtu, a...?

Gani Osmani: Me ta tregu të vërtetën, une nashta as në ondërr s'e kom pa. Se tash me kry shkollën fillore gati fëmi je, domethonë kur e kom kry shkollën fillore. Tash o pak ma ndrysh, tash në shkollën fillore, nashta në klasë të pestë fëmija e zgjedh profesionin e vet, dej në klasë të pestë që shkon ai orientohet. Atëherë u kanë pak ma ndrysh, atëherë prindët tonë kanë kqyrë, tregova edhe ma parë, me ardhë sa ma shpejtë te puna. Ko industria edhe xehëtaria u kanë e zhvillume në Mitrovicë, atëherë ja u duft mu kanë xehëtar, ja kimist, ja teknolog, gjeolog, qeto për me ardhë me hi në punë. Edhe baba ma ka jep drejtimin, prindi im ma ka jep. Edhe une i kom djelt e axhës tre, katër a pesë i punojnë sot, krejt teknik të xehëtarisë janë. Domethonë, edhe ata mixhallarët tonë e djelt e mixhës babës i kanë orientu në qat', në qat' drejtim. Tash shkoj ai para meje që u kanë xehëtar, "Tash me punu si teknik mbikëqyrës

duhet me shku edhe ti". Prindët na kanë regjistru në shkollë edhe u shku në qat' farë, në qat' mënyrë domethonë. Se nuk e kom zgjedh profesionin unë, nashta e kisha zgjedh ma të mirë, po jena hi në qato edhe tash... adaptohet njeri.

Kur jom hi në fillim shumë vështirë m'u ka dok. Kur jom hi në fillim thojsha, "Mujsha me dalë prej miniere mo kush që më shtin s'ka". Kadal-dale. Ma së pari më ka ra me punu në ndërrimin e tretë. Pa hi në minierë, as praktikë, ndërrimin e tretë jom ardhë, s'e kom ditë as ku po shkoj. Ni mixhë e kom pasë që ka punue, u konë në ndërrim me mu aty, afër me shpi' m'ka marrë edhe i ka thonë, mbikëqyrësit që u konë mbikëqyrës i horizontit i ka thonë, "Kqyr bre se osht' i ri merre me veti, ruje kapak". Më ka marrë, më ka çu as s'kom ditë ku po shkoj, as çfarë pune kom. Veç tu u adaptu kadal-dale, shoqnia edhe lidhja është me minatorë është lidhja shumë afër, ndërmjet veti minatorët. Mas një kohe po të tregoj m'u doke larg, m'u ngatke me shku në punë. A në fillim m'u ka dok shumë vështirë, domethonë adaptimi çdo njeri ja bon punët ma të lehta. Adaptimi edhe tashti ni pagë e merr, me shoqni e kalon kohën.

Anita Susuri: Qysh ju ka dok kur keni hi mrena aty për herë të parë?

Gani Osmani: Na e kena bo edhe, na e kena bo edhe ni praktikë ma herët kur jena konë në shkollë, kena bo praktikë nashta ni herë në mujt.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Po ishit t'u më tregu për herën e parë kur keni ardhë.

Gani Osmani: Po, kur kemi ardhë ma së pari në minierë më ka ardhë shumë vështirë, që kom thonë, "Në qoftë se edhe një herë muj me dal mo, s'ko me ardh, hiç s'ko me hi" qaq që mu ka dok keq, vështirë. Na tregum, e kena pasë ma herët edhe një praktikë e kena bo, nashta një herë në mujt me profesorë jena ardhë prej shkollës, po atëherë veç na kanë çu nëpër korridore, në vena të mirë. Po kur kena shku na në vena, nëpër punishta, shkallëve, janë ato shkallët e vena të rrezikshme, m'u ka dok keq. Mirëpo, mas një kohe jena adaptue, me shoqni e me... domethonë, m'u ngatke me ardh në punë edhe pse ka qenë punë e vështirë.

Edhe masanej, nuk e ceka kur kena shku na me kry praktikën ja kena nisë me punu si mbikëqyrës, teknik të xehëtarisë edhe mbikëqyrës, një 90 përqind librat janë shkru sërbsht. Edhe orari u konë sërbsht, orari i punës edhe defektet janë lexu sërbsht. Ka pasë... numri ma i madh i punëtorëve ka qenë diku 80 përqind kanë qenë shiptarë, një 20 përqind kanë qenë sërbe. Mirëpo, edhe ata shiptarët do çka janë konë ju kishin dhonë qat' bindje që me dhonë orarin sërbsht që me kuptu këta tjerët. Kur kena shku gjenerata... po na bjen pak si lavd, veç kur jena shku na një 24 para punëtorë dhe ata ishin ni gjeneratë pak jonë konë para neve ja kena nisë na me i shkru librat në shqip.

Se librat shkruhen, osht' libri i mbikëqyrësit kur shkon pi ndërrimit parë, se une mbikëqyrësin e ndërrimit të dytë nuk e shoh, e shkruj në libër çka ka defekte, qysh po hecë puna, ku kom punu, domethonë gjithçka çka kom punu e shkruj në libër. Ja kena nisë na me shkru, ja kena nis ëshqip edhe ja kena nisë orarin me dhonë shqip. Edhe kena thonë, "Në qoftë se nuk kuptojnë sërëbët, mundemi me ja spjegu tajshi [pastaj] sërëbisht, mirëpo orari edhe puna zyrtare duhet m'u konë shqip". Edhe ka vazhdu prej asaj kohe gjithë jonë shkru në gjuhën shqipe.

Anita Susuri: A keni pasë naj problem për qato?

Gani Osmani: Jo, s'kena pasë problem, se aty veç u doke që shumica janë shiptarë. Po të tregoj në venat ma të zorshëm që je konë, janë konë minatorët shiptarë edhe jonë konë ni pjesë, ka pasë edhe romë, ka pasë boshnjakë, ka pasë edhe sërëbë, ka pasë edhe sërëbë, unë punëtorë e kom pasë që u konë xehëtarë. Mirëpo, u konë një numër ma i vogël. Venat ku jonë konë si elektrikistë, makinistë, do vene ma të, ma të lehta jonë konë sërëbët, në venat kyç janë konë sërëbët. Mirëpo, veç u pa tajshi që shumica jonë shiptarë edhe duhet me ju fol në gjuhën shqipe edhe s'kem pasë tajshi... masanena jonë ardh edhe inxhinjera shiptarë, e kena pasë ni numër... u bonë do drejtora, do... jonë bo shiptarë, se shumica jonë konë sërëbë.

Anita Susuri: Para se me u bo greva kanë qenë marshet.

Gani Osmani: Po.

Anita Susuri: A munesh me më tregu qysh jonë organizu, a po të kujtohen qato ditë, a u ditë çka po bohet a...?

Gani Osmani: Shiqo, këtu, këtu shumica njerëzve nuk i kanë ditë, me ta tregu të vërtetën as unë nuk e kom ditë. Kjo masanej na e kena kuptu, kjo u konë krejt në mënyrë organizative, domethonë organizim i fortë u konë. Këto na i kem pa pakënaqësitë që jonë bo, domethonë të drejtat, penzionimi i këtyne profesorëve, intelektualëve, domethonë shkelja, u folë marrja e kushtetutës. Domethonë, aty krejt çka ka ndodh për shtet, jo për të drejtat sociale të punëtorëve, po ato pakënaqësitë jonë mledh, domethonë për shtet janë bo, çka u shkelë e drejta e shtetit. Edhe tash edhe udhëheqësia po edhe minatorët e kanë pa se me dialog, ato jonë shtjerrë rrugët, me dialog janë shtjerrë të gjitha. Ata kanë mendue, na kem mendu se me marsh ose me protesta qysh i bojshin, i kanë bo një kohë shkijet përpara edhe duhet me bo me shpreh atë pakënaqësinë.

Mu veç më kujtohet prej ndërrimit parë kur janë dalë ata, që janë dalë tash, ndërrimi i tretë janë dalë, ndërrimit parë ju kanë bashku edhe jonë bo qetu. Burhani [Kavaja] më kujtohet si sot, u dalë, "Ku po doni me shku?" "Për Prishtinë" "Ju për Prishtinë edhe unë për Prishtinë me juve". E di, më kujtohet fjala e tina. Edhe jem nisë në komë, ka pasë tentime edhe prej këtuhit, sigurimit, ka pasë njerëz qitu që

jonë konë të sigurimit, civilë, janë ardhë policë e kanë tentu me i nalë. Mirëpo, kur e kanë pa që nuk po nalen, janë nisë në kamë teposhtë. Tash t'u shku rrugës teposhtë, unë e di që jonë bashkangjitë prej qitu në Tunel të Parë e në Stantërg ju kanë bashkangjit popullata. Kanë vazhdu tajshi për Mitrovicë kur janë shku, ju kanë bashkangjitë rend.

E di kur kemi shku... nuk e di a në Novosellë, a konë, kur janë dalë prej, prej, prej Prishtine që ka ardhë Remzi Kolgeci edhe nuk m'kujtohet dikush tjetër që kanë tentu me na nalë. Kanë thonë, "Kthenu!" I ka çu dikush prej atjehit. Edhe jonë konë dy kordona me polici, jena hi arave anena edhe kena vazhdu. Domethonë, nuk ka intervenu policia atëherë, nuk ka intervenu, jonë munu me na nalë. Po atëherë veç janë ardhë popullata, u shku tu u rritë. Atëherë u konë sistemi që prej këtu u marrë edhe fotografia e Titës edhe u konë flamuri jugosllav edhe flamurat tonë. Domethonë, na në atë mënyrë, në njëfarë mënyre kena dasht me tregu që na s'jena kundër kërkuj. Se atëherë ni protest me bo thojshin, "Po do me rrëzu shtetin, po do me rrëzu Jugosllavinë". Na me ato sheja kena dasht me tregu që na nuk jena kundër shtetit as kundër kërkujt veç jemi për me i mbrojt të drejtat tona.

Atëhere janë shkue, jena shku në komë, ka ndodhë ni pjesë janë ardhë autobusat, ndodhë që janë hyp edhe në autobusa, dikush që u lëndu. Se na jena shku me mjete të punës, me kësi çizme, nashta najkujt i kanë ra të mdhaja t'u hecë, kom pa punëtor që edhe i ka dathë krejt, e kanë vra çizmet, se ato kur janë ma të mdhaja, ajo të vret, çizmja edhe me hecë kogja ni kohë, i kanë dathë, unë i kom pa edhe dathën që jonë shku. Jonë shku atëherë na ka drejtue, jena shku jena hi në sallë. E di që e kanë lyp Azem Vllasin, Kaqusha Jasharin, këta që i kanë... se këta... na kem ni atëherë që dojshin m'i shkarkue këto edhe na e kem lyp edhe mbrojtjen e tyne, funksionarëve tonë, edhe e kem lyp dorëheqjen e qatyne Rrahman Morinës, Hysamedin Azemi e qata që jonë konë. Domethonë, ata i kena urrejt njëfarë mënyrë.

E di jena hi atëherë u konë tajshi numër i madh, shumë u konë numër i madh se u përzi edhe popullatë edhe rini edhe studenta ka pasë. Edhe jena hi në sallë, edhe kena ni kur kanë diskutu shokët tonë, se ja u dhojshin fjalën atëherë. Kallxova u konë atëherë na i thojshim Tahir Salih, po ai osht' ky... po ja harroj emrin, Tahir i thojshim na, Tahir Salihu, po ky e ka ndrysh, ky Salihu mbiemrin, ky... s'po më kujtohet tash. Kur ka diskutue në sallë, ka diskutu Ramiz Osmani, u konë ni djal i mixhës tem, bile...

Korab Krasniqi: Rasim Salihu?

Gani Osmani: Rasimi po, po edhe një tjetër u konë, ky... nuk po më kujtohet për momentin, nashta ma vonë. Ka... Ramiz Osmani ka bisedu, domethonë Esat Jusufi, janë konë do shumë që kanë diskutue, kanë thonë që, "Na i mbrojmë, minatorët janë për me i mbrojtë të drejtat e veta, me i mbrojtë funksionarët, domethonë i hjekum, nuk i pranojna pushtetarët të cilët nuk na përfaqësojnë neve". Veç e di që në qat' kohë solidarizim ma i madh si në qat' kohë kurrë s'ka pasë, as s'besoj kurrë në jetë që ka me pasë.

Domethonë, krejt Kosova jonë konë në rrugë, nejse edhe mjetet e informimit, edhe krejt jonë konë të bashkum, domethonë jonë konë ni gojë, ni qëllim. Nuk besoj që vjen mo... që ka me pasë qasi organizimi. Domethonë, nuk munet kërkush me organizu asni grevë, asni protestë me thonë, “Hajde me zor në grevë”, po vetorganizim. Domethonë, mllefi edhe ajo pakënaqësia, e ka shti m’u vetorganizu. Edhe kur vetorganizohet ai edhe jetën e rrezikon edhe nuk hjekë dorë prej asaj, domethonë këta janë konë të vetorganizum, po u konë shumë organizimi i mirë.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu tani, ka përfundu ajo të salla “Boro Ramizi” më duket...

Gani Osmani: Po, “Boro Ramizi” që u konë ajo salla, qaty ku osht’ tash. Po tajshi dikun dej ka ora 11:00 mos gabofsha tash, osht’ kohë shumë e gatë edhe nashta që s’kom marrë kështu shënime... diku dej ka mas 10:00, ora 11:00, tajshi me nifarë marrveshje edhe me këta funksionarët tonë edhe ja kanë nisë m’u shpërnda. Tajshi i kanë qit nëpër autobusa ku i kanë shpërnda, i kanë qit nëpër autobusa edhe jonë ardhë. Tajshi masanej ka fillu kjo, policia në pyetje, në mënyrë të msheftë nashta, nashta jo po e di që ka marrë njerëz, veç i ka ardhë thirrja qitu {tregon me kokë majtas} kur u dalë prej pune edhe e kanë marrë në pyetje edhe s’ka ditë që po e merr, mos m’i tregu njoni-tjetrit. Edhe e ka marrë në pyetje edhe i ka thonë që, “S’guxon ti m’i tregu kërkujt që je konë në polici”.

I kanë malltretue kush u konë e nashta prej dikujt kanë nxjerr naj fjalë e, prej dikujt qashtu. Veç u konë shumë, shumë kohë e vështirë. Tajshi masanej mas marshit greva filloi. Domethonë, si u pa që nuk ka rezultat marshi edhe gjithë ai realizim, këta minatorët e kanë vendos që me hi edhe në grevë. Domethonë, me 20 shkurt, me 20 shkurt ka fillu greva që u hi në histori, greva ma e madhe me numër të minatorëve edhe kohën ma të gjatë që ka nejt në minierë dikush. Edhe tash m’i thonë dikujt, rinisë, nashta edhe gjeneratave ma të vona nuk beson, nuk beson. Na ka ndodhë mas lufte qetash kena pasë grevë, nashta pesë-gjashtë orëshe, qekjo gjenerata e re s’ka mujt me përjetu, s’ka mujt m’i përballue, “S’muj me nejt”. Tajshi filloi, që thash greva edhe greva u konë organizim i mirë i vet minatorëve.

Anita Susuri: Në cilin ndrrim ke punu ti qat’ ditë kur ja ka fillu?

Gani Osmani: Une kur ka fillu greva kam qenë në ndrrimin e tretë, domethonë kur ka ardhë ndrrimi i parë, ndrrimi i parë nuk u dalë prej pune. Jonë ardhë ju ka bashkangjitë ndrrimi dytë, une kom ardhë në të tretin, qashtu kom qenë, se unë kom qenë me ndrrime. Edhe tash, unë kam ardh në ndrrim tretë po ka ndodhë që edhe nuk kanë prit njerëzit, u konë në ndrrim të tretë edhe u ardhë meniherë si e ka marrë, si e ka kuptu. Edhe u ardhë numri t’u u rrit edhe i kanë shfaq ato paknaqësitë, e di, u konë... se tash çdo grevë që të shpallet, shpallet ni... hyjnë në grevë minatorët... se unë kom pak përvojë në këto, nashta rrijnë nja pesë-gjashtë orë e lyp kërkesa, drejtorin ose diçka. Nuk, nuk zgjedh këshill grevist niherë se mendon që po zgjidhet problemi për momentin ma të shpejtë. Edhe këta njëherë i kanë bo do kërkesa, kanë pa që s’ka rezultat, tajshi tu u rrit numri, tu u rrit e kanë shpall, e kanë shpall grevë urie, grevë urie edhe u bo këshilli grevist.

Domethonë, çdo horizont i ka pasë përfaqësuesit e vet që janë konë. Përfaqësuesit, horzonti i nontë për shembull i ka pasë tre ose katër, si njerëz ma të vjetër janë konë atëherë, mbikëqyrja ose punëtorë shumë të vjetër të besushëm, që janë pak me përvojë, se ka qenë edhe rrezik se ka pasë edhe municion në atë kohë. U duft m'i kontrollu edhe depot e municionit edhe në minierë ka pasë vena të rrezikshëm, mos po bje poshtë po mytet dikush, ja hup atë efektin e grevës. Domethonë, gjithçka ka qenë në kontroll, gjithçka. Tajshi i kanë shfaq këto kërkesat e tyne, pikat çka janë. Mirëpo, me zgjatjen e kohës, janë zgjat edhe kërkesat e minatorëve. Nashta njëherë janë konë dy-tri kërkesa, janë shku deri dymdhetë-tremdhetë. Tu u shtu kërkesat domethonë, tu u rrit numri minatorëve edhe koha, koha ma e gjatë, janë shtu edhe kërkesat.

Anita Susuri: Këto kërkesat këshilli grevist i ka përpilu a?

Gani Osmani: Po, ato i përpilon çdo grevë i përpilon këshilli grevist.

Anita Susuri: Në cilën ditë janë bo këta, këshilli?

Gani Osmani: Po tash nuk më kujtohet veç mos gabofsha qat' ditë në mëngjes, diku në mramje ose nesër tash s'jom shumë i sigurtë. Veç mrena 24 orëve veç u formu këshilli, mrena 12 orëve, jo 24 orëve u formu këshilli grevist. Nejse, ato kërkesat dihet çka janë konë, thash edhe pare, çdo minierë, çdo punëtor që bon greva, bon për kushte të veta, për rritje të pagës, për mjete të punës. Po kjo ka qenë ma, ma specifike se kjo ka qenë greva e vetme që kanë bo, grevë për mbrojtjen e shtetit, mbrojtjen e kushtetutës, mbrojtjen... atëherë e kanë bo pensionimin e profesorëve, të intelektualëve para kohe, ata e dijmë ma mirë edhe tash ren ato, ato kërkesat. Tajshi masanej kur e kanë pa që nuk, nuk po dojnë funksionarët tonë që janë konë në pozitë... u konë Rrahman Morina, Hysamedin Azemi, edhe Ali Shkurija, kur e kanë pa që ata nuk po dojnë m'i përfillë këto kërkesat tona, tani u shtu tjetra kërkesë edhe dorëheqja e tyne.

Tajshi janë shtu ren kërkesat njo mas njo, domethonë qëllimi ka qenë i qatynëv, qetynev kërkesav. Tajshi ka pasë edhe... këshilli grevist ka pasë edhe kon me lëshu me hi në minierë, kon mos me lëshu. Ka pasë që gazetarët sërbë e kanë pasë të ndalushme, se dalshin bojshin propaganda. Janë konë tash ni grup nashta pi qatij këshillit grevist, dy vetë në portë me kqyr kush po hin edhe kush po del në portë. Tjetri ka pasë me nejt aty te pusorja, aty te hymja minierës, tjetri ka pasë me u siguru me ushqim. Domethonë, ato janë konë, ato janë konë të zgjidhne prej atij, janë konë këshilli grevist edhe atje poshtë që i kanë nimu edhe njerëzit që janë konë ma të besushëm, e kanë majtë renin, e kanë majtë disiplinën. Dikush u konë ma orator, ka fol, se u konë orator, i lindur osht' dikush orator, dikush o shumë patriot, po me fol nuk dinë.

Domethonë, edhe ajo ka lujt rol, nashta puëntor i thjeshtë që u konë Avdi Uka, u konë Asllan, ni Asllan, u konë Esat... Esati edhe këta janë konë që janë konë shumë orator të fortë edhe kanë diskutu para gazetarëve, para... Edhe, edhe u konë nifarë trimnie se edhe me bisedu s'ka guxu gjithkush.

Domethonë, ata e kanë pasë njifarë vullneti. Asllan Salihu u konë ai si mbikëqyrës edhe u konë... bile, bile më kujtohet kur u ardhë kjo, u ardhë Nadire Vllasi, gruja e Azem Vllasit, u konë gazetare, dikun në gazeta boshnjake, nuk e di, e më kujtohet se tha, “Nuk po dojnë me dhonë dorëhjekje ata, qato kërkesat. Edhe...” tha, “nuk po dojnë”. E di atëherë pak ka eskalu situata. Kur më kujtohet qeky Asllan, Asllan Dedija u konë, tha, “Krejt që nuk na realizohen kërkesat tona” tha, “na me dalë pi ktyhit jo. Krejt” tha, “kena me ra në pusore”. Ata i thojshin shakt pusit që, që dalim.

Edhe u hallakat tajshi pak aty, do ja nisën me kajt, e do... veç u shku nifarë, a din, nifarë pakënaqësie, nifarë hallakame. Po une apert thom, duhet me falenderu edhe këto njësitë tjera, krejt na kanë përkrah. Ma së pari KEK-u në atë kohë, atëherë u kon Llazër Krasniqi, u konë udhëheqës i KEK-ut. Rrymën me nalë na s’kishim mujt me nejt në minierë, rrymën. Se rryma ajrin e bon, domethonë ajrin... e shtin me bo kompresori, rryma. Mos me pas ajër atje pesë-gjashtë orë nuk mund rrin në minierë se prishet ajri meniherë. Rrymat e ajrit hijjnë me kompresor, gjithë ai numër i madh që u konë. Po u konë në kordinim edhe KEK-u edhe ministria, këto, mjekësia edhe popullata. Me i falenderu shumë popullatën, kanë dhonë ndihma, se na e kena shpallë grevë urie në opinion, mirëpo e kena pa që me grevë urie nuk munëm me... masanena e kena përdorë edhe ushqimin.

Kur kanë ardhë në fillim gazetarët na kena thonë, “Jena në grevë urie” edhe nashta s’na ka pa kërkush. Mirëpo, na pa marrë ushqim s’kena mujt, se u duft me marrë ushqim e me marrë barna, me marrë këto. E domethonë, popullata na ka përkrah, u konë edhe njësia e veçantë që u dalë e ka marrë ushqimin jashtë në depo, e kanë shpërnda nëpër minierë. Domethonë, mos me konë popullata, mos me konë solidarizimi i të gjithëve, na grevën s’kishim mujt as, jo tetë ditë, po tetë orë s’kishim mujt me majtë. Domethonë, me ju falenderu të gjitha këtyne.

Anita Susuri: Në cilin horizont ti ke qëndru gjatë grevës?

Gani Osmani: Une kom qenë në horizontin e nontë. Aty kom qenë t’u punu, po kom dalë kaniherë edhe në horizontin e tetë, ka ndodhë se une jom konë... nuk jom konë në këshill organizativ po i kom pasë ata shokët edhe kom punu, bashkëpunu me ta se unë jom konë ma i ri. Mirëpo, ka ndodhë që kur jonë ardhë funksionarët e mdhaj janë shku ma shumë në horizontin e tetë se u konë pak ma gjonë. Veni ma i gjonë edhe pozita ma e mirë edhe na jena konë gjithë të njoftum kush po vjen, gjithë i kena ditë, e jena dalë nalt i kena prit. Domethonë, une kom qarkullu nëpër horizonte. Po zakonisht u konë rregullore që çdo kush ku o t’u punu në qat’ horizont me nejt. Ka pasë prej horizontit të parë deri në horizontin e nontë, i fundit, i nonti u konë horizonti i fundit. Domethonë, i dheti pak ka punu, po horizonti i nontë u konë kryesor edhe i teti.

Anita Susuri: A u konë rrezik krejt ata njerëz përneherë m’u konë mrena në krejt horizontet?

Gani Osmani: Aty u konë, aty u konë rrezik me eskalu situata edhe me marrë naj veprim nashta katastrofal unë po thom. Aty u bisedu, une vet i kom ni, u bisedu gjithçka, aty u bisedu, “Në qoftë se

nuk merren kërkesat tona parasysh na kem me bo vetëvrasje, kemi me minu minierën”. Domethonë, jonë konë do, veç u duft me konë kontrolla shumë e fortë, se aty si të nisë me dal situata prej kontrollit, nuk dinë kush çka po bohet. Edhe u konë rrezik prej naj smundje, naj infektimi, tash o shumë numër i madh, aty kanë bo edhe dezinfektim veç me qireq [gëlqere]. Unë e di, kanë marrë qireq prej nalti, se tash më falni në shprehje edhe nevoja u kry qaty, e gjithë ai numër i madh, kanë marrë qyreq edhe me qyreq t’u qit nëpër toka asajde që kanë nejt e nëpër vena. Qireqi osht’ një lloj dezinfektimi, domethonë ka mujt me marrë naj smundje edhe me marrë smundje të gjithë, edhe m’u smu. Po fati ka ndodh që as nuk ka vdek kush, smundje ka pas që janë dalë nalt, u bo spitali improvizum, ka qenë nalt, u smu dikush i kanë qit nalt, mjekët i kanë kqyr, ju kanë dhonë infuzion.

Mirëpo, në shpi nuk kanë pranë me shku edhe në spital s’ka pranë me shku. Domethonë, ka thonë, “Kom me nejt qitu, që sherojna kom me u kthy në grevë apet, që s’sherohna dej të kryhet greva kom me nejt qitu”. Unë e di ka pasë vizitë, ka pasë vizita shumë. Ka pasë gazetarë tyrli kahit, ka pasë edhe të jashtit. Ka pasë... këtyne ju interesojke, më kujtohet sllovenë edhe kroatë, ka pasë shumë që na kanë përkrahë në atë kohë se ata edhe e kanë ditë çka po ndodh, a po kupton, edhe tash thotë njëfarë fjale, armikun e përbashkët e kena pasë edhe na kanë përkrahë. Ka pasë edhe të jashtit na i kena përcillë edhe gazetë që jonë shkru, edhe gazetë. Mirëpo, me shpi kontakt na s’kena pasë, unë për veti. Se atëhere s’ka pas telefona, s’ka pas lidhje, s’ka pas... domethonë, me shpi veç kush çka ka, përmes informimit çka kanë marrë vesh shpija jonë që minatorët janë mirë, me vdekë s’ka vdekë kërkush, janë grevë urie, po kërkojnë qeto, domethonë qato e kanë ditë minatorët, se këta familja jonë nuk kanë ditë kurgjo.

Edhe ka pasë njerëz të smutë, une po thom, që nuk janë shku une e di vet. Janë dalë edhe prej qaty i kena qit, “Jo s’po du me dalë, po du me nejt”. Se ka pasë edhe të moshum. Atëherë na jena konë të ri, po ka pasë edhe të moshum 50 vjet ka pasë punëtor që o tash nuk mun i përballon sikur ai 50 vjet sikur ai 25 vjet. Mirëpo, krejt këtë pjesën në sipërfaqe, jonë konë ambulancat, e di une. Ka ndodhë i kena qit dikun të smutë, jena kthy. Janë konë shtretërit, jonë konë prej Prishtine mjekët që janë ardhë, motra prej Mitrovice, krejt. Domethonë, gjithçka u konë e improvizime, gjithçka u konë që... unë edhe pare thashë kurrë në jetë s’besoj që munet m’u bo ni qasi greve qaq e madhe, qaq organizim i mirë edhe qaq solidarizim i krejt popullatës, kurrë s’ka me ndodh mo, kjo kurrë s’ka me ndodh mo!

Anita Susuri: Ato momente kur je konë ti mrena aty çka ke menu që ka me ndodhë, çka ke prit prej qasaj?

Gani Osmani: Po shiqo, neve niherë ardhke na prujke ni lajm të mirë, a beson na dhonke ni vullnet. “Jo ka me dhonë dorëheqje ky, jo ka me bo këto, keni me asi...”. Kur mas nja ni ore ardhke tjetri na jepke ni lajm të keq. Edhe dikur neve na, na hupën shpresat, me tregu nuk dishum as çka po... po na hinëm edhe, edhe vendosëm qashtu. M’u më kujtohet kur u ardh ni mjek kroat, u konë kroat mjek edhe pi bon njoni pyetje aty, thotë, “Qysh osht’ e mundshme me qëndru këta, pse po qëndrojnë kaq shumë?” Ish pesë-gjashtë ditë që ish bo. Thotë, “Kjo osht’ lloj smuje, smundje” thotë, “thirrët egoja kolektive.

Egoja kolektive” thotë, “kur të kap vdes njeri qaty edhe nuk çkoqet pi sajna”. Domethonë, e ka kap qajo lloj smundje me shoqni edhe mo nuk dinë a ka familje, a ka fëmijë, a ka... domethonë, e ka kap në krye qajo smundje edhe qaty vdesin tonë bashkë edhe nuk ndahën. Domethonë, a din na spjegojke nifarë mënyre.

Edhe une po thomë dikur, qysh thotë populli, na hupi topi, na vendosëm që ja kena me realizu, ja kem me metë. Njo ardhke të lajmrojke mirë, tjetri ta prujke lajmin e tjetër. Me të tregu të vërtetën kur e lypëm na dorëheqjen e tyne, tha, “Na e prunën me shkrim”, po dhojnë dorëheqje këta tre funksionarë. Na i thamë, “Veç me shkrim bina”. Erdhën me shkrim na e prunën fallc, fallc. Se na nashta dikush s’e kem ditë, po na e kem ditë çfarë vule e ka kryesia e Kosovës edhe çfarë vule e ka komiteti. Domethonë, tjetër vulë e ka komiteti, tjetër e ka... atëherë komiteti u konë, Komiteti Qendror që u konë. E prunën vulën fallc, tha, “Jo këto fallc duhet me i kthy”. I prunën ato me vulë orginall i dhanë nënshkrim. Kur dulën atje erdhën tjerët thanë, “Jo tash nuk e kanë pranë”. Niherë po pranon tash jo s’po pranon, a po kupton nifarë mënyre, do farë mashtrimesh.

Po tajshi edhe na mashtrunë neve kështu ashtu, e prunëm orginallin, dulëm përjashtë, ajo u konë orginall që e kanë pru nënshkrimin e krejt dorëheqjen. Mirëpo, prapë u kthyn. Na e kem bo atë qëllimin tonë, e kena arritë ato tonën, kërkesat jonë konë krejt reale, tajshi kanë lind kërkesa, masanena që thash janë shtu kërkesat. Se na e di shum si të dalim prej miniere, kena me pasë pasoja me polici e me ata njerëz çka kanë me fol, ndër pikat u konë edhe kërkesa u shty tjetra që organizatorë nuk ka. “Na jem organizatorë të gjithë, domethonë, nuk ka organizatorë”. Tajshi u shtu kërkesa për pajtimin e gjaqeve, prej miniere ka rrjedh. Mu më kujtohet fortë mirë që ka propozu njeri me bo pajtimin e gjaqeve përmes këtyhit. Domethonë, sa kanë nejt aty kërkesat janë shtu masanena. Domethonë, krejt këresat çka janë konë, janë konë reale, janë konë domethonë për shtet edhe për shiptari, nuk jonë konë asnjë këresat individuale.

Mirëpo, forca të mashtron, forca... na nuk kena dalë, nashta e kemi ditë që s’bohet, po neve na kanë mashtru, jena dalë. Masanej ja ka nisë policia njo ka njo m’i marrë ren, çdo njeri që u konë në grevë u konë 60 ditë i dënum. 60 ditë e ka pasë të preme me të shti niherë aty, tajshi varet kush kujna ja ka vra synin. Tajshi i morën këta 14 të akuzum në krejt venat kyç. Domethonë, ja kanë nisë prej drejtorit, jo prej drejtorit po ja ka nisë prej Azem Vllasit, ja kanë nisë, në KEK që thash u konë ai Llazër Krasniqi, ja ka niës drejtori gjeneral, tajshi ky zavendsi i tina, drejtori teknik, ja kanë nisë inxhinjerat këtu, i administratës që u konë. Krejt kush e ka përkrah, se na i kemi pasë do që nuk jonë konë në minierë në grevë hiç, përjashtë u konë, sekretari për shembull u konë përjasht, organizator greve. Tajshi, minatorët i kanë marrë krejt qata që kanë diskutu, janë kamerat, televizionet, qaj që ka diskutu ma së shumti qato e ka marrë.

Edhe une kom pasë shokë nashta duhet edhe m’i cekë, Jetish Bajrami u konë në grup që u konë i burgosun, tash osht’ i vdekun. Thotë, më ka tregu thotë, “Dy-tri herë na ka ardhë dënimi me vdekje”, domethonë, vendim i shtypun ju ka ardhë dënimi me vdekje, qatyne 14-ve. Qaq u konë aktakuza e

rondë, dënim me vdekje, tu i malltretu, e tu i rreh e... Domethonë, masanej i kanë marrë edhe punëtorët në pyetje, dëshmitarë kanë marrë, punëtorët me ju bo dëshmitarë atyne. Jonë dëshmitarët e gjallë. Ata kanë nejt 14 muj në burg, tajshi mas një kohe i kanë lëshu, erdh situata qashtu. Veç as na, as kërkush s'ka mendu që qata njerëz kanë me dalë prej burgu. Na kena mendu ata kanë mi likvidu gjithqysh se qaq sistemi i ashpër u konë.

Pjesa e Tretë

Gani Osmani: Kur erdhëm na mas greve, i murën ata në burg, ja fillun me i thirrë në punë me bo përçamje. E di si sot kur jena ardhë {tregon me kokë majtas} këtu porta mshel. Shembull, Gani Osmani nuk hin në punë, filan fisteku hin në punë. Edhe na kena thonë atëherë edhe në grevë, “Njo për të gjithë...” u konë edhe ajo kërkesë, “Njo për të gjithë, gjithë për njo”. Edhe kena thonë, “Ja kena me punu të gjithë ja s'kena me punu asnjë” edhe e kena ndërpre punën. Domethonë, edhe qata që na i kanë thirrë nuk, nuk kanë vazhdu me punu, e kanë bojkotu punën. Se një numër i vogël i kanë thirrë me punu.

Tajshi masanena u formu ni... masi janë dalë prej pune, u formu ni sindikatë, ni sindikatë e pavarne që punëtorët me ditë pak edhe ku m'u orientu, se atëherë drejtorat, këta ni pjesë i shtinën në burg, ni pjesë u shpartallun, do shkunë jashtë, shumica ikën nëpër perëndim, se ikshin edhe prej policie, prej, prej... Edhe ni pjesë e punëtorëve metë në mëshirën e kërkujna, të papunë, pa paga, pa idare, familja kërkujke ushqim, me punu kun s'mujshë privat. Edhe u formu sindikata e pamvarne, Xhafer Peci, Xhafer Nuli ka qenë kryetar sindikate, me një grup inzhinjerash këtu edhe teknikësh. Edhe ja ka nisë me punu sindikata atëherë, kanë dhonë ndihma prej tana anëve të Kosovës, kanë dhonë edhe prej jashti.

Anita Susuri: Para se me vazhdu qaty po du edhe diçka për grevën me pyt. Kur keni dalë prej grevës, se tetë ditë jeni konë aty, kur ke dalë jashtë qysh u konë edhe me na tregu krejt qat' përjetimin tond edhe në familje kur ke shku çfarë pritje...?

Gani Osmani: Shiqo, une, veç më kujtohet kur kena dalë prej greve... se tash aty kur të hin në atë koshin, kafazin e njerëzve, kur hin i mrami atje, te dera, ko delë i pari. Une e di që jom hi ma i mrami, kur jom dalë aty po të garantoj një njëqind a dyqind kamera ishin konë te pusorja, janë konë. Se ju ka interesu, ka pasë... ju ka interesu shumë opinionit se u konë, u bo e madhe. Veç e di që, si jom dalë i pari, m'i kanë mshel sytë, se mjeksia e jepke, “Si kanë nejt shumë në terr, munet edhe m'u verbue me pa dritën”. Edhe tash si je dalë menjihërë t'i ka mshelë sytë edhe të ka kap për krahësh, se edhe ndrrimi i ajrit, edhe ndrrimi i ajrit. Janë konë ata mjekët e këtushit edhe të kanë vet, “A po don me ra në spital, a po don me shku në shpi? Që je konë i smut, ka ndodhë plot nuk janë shku në shpi. U konë ni spital i improvizum, u thirrke, janë shku.

Une e di, veç e di që i kom pa edhe kur jom dalë jashtë nja dhetë ose pesëmdhetë ambulanca i kom pa, se përpara që ishin konë, para pusores aty. Edhe ju kom thonë, “Jo, une po du me shku në shpi”. Na kanë çu nëpër shpia, unë jom shku në shpi. Tajshi, aty kur jom shku në shpi, nifarë, nifarë pitje pak ma (buzëqesh)... Edhe do jonë metë këtu, do jonë shku në shpi. Tajshi mo s’na kanë lonë as me ardhë në punë, as me ardhë... Na kena dashtë nesrit, tajshi me të tregu, nesrit paradite jom ardhë këtu, në “Trepçe”, po nuk lojshin as me hi, se kishim qef m’i pa këta... edhe mas, tash s’po di a mas ni dite, dy, ju ka hi policia... se e kem pasë na ni kojshi të afërm aty edhe si dhondër, që u konë në spital edhe ju ka hi njësia speciale, i ka qitë krejt përjashtë. Ju ka thonë, “Menjiherë me shku nëpër shpia”. U hjek edhe i kanë hjek me kreveta, me ato mjete, domethonë e ka paqllais këtu, e ka pastru krejt.

Nuk i ka lonë as dy ditë, e ka kap shteti edhe policia e ka kap në dorë për me hup gjurmë edhe mos me pa kërkush kurgjo. Domethonë, kjo ka përfundu qishtu, tajshi masanej papunësia. Une po të tregoj prej që ka përfundu greva, deri në vitet lufta që ka përfundu... une e kom ko [ktu] fshatin Dedi {tregon me kokë majtas} edhe ka ndodhë që kena shkue ose në fshat temin, s’kom guxu me hyp në autobus. Se i ka nxonë nëpër autobus, na jena konë të dënum të gjithë. Kurrë, s’kom guxu, ja u duft me shku në kambë se policia u konë në punkt qitu në tunel të parë ose atje te vorret që janë në hymje të qytetit. Do vena janë konë kyç edhe veç ju ka hi autobusit me regjistër. Ta ka pa emrin s’të ka vetë veç të ka kap, se je konë ti i dënum. Domethonë, çdonjoni u konë i dënum, 60 ditë i ka pasë të preme edhe i arrestum, njifarë mënyre, sikur kur je i arrestum që je...

Anita Susuri: Secili grevist i ka pasë 60 ditë?

Gani Osmani: Çdo grevist i ka pasë. Unë e di shokët tonë mas katër vjete, pesë vjete e ka la burgun. Edhe une nuk ju kom ra në dorë, une s’jom hi në burg. Po tregoj kur ka ndodhë, jom ardhë me kerr, ose me naj diçka deri në rekë [lum], jom zhdryp përmas banesav, jom dalë ko te tunelli jom hyp, që mos, mos me ra në dorë tyne se s’të ka vet. Domethonë, çdo grevist u konë i dënum 60 ditë, të preme i ka pas. Tajshi, ata i kanë marrë në pyetje, nashta u shku për 60, ka nejt dy-tri vjet. Veç 60 vjet i kanë pasë të preme krejt.

Tajshi papunësia e madhe, po tregoj, ti s’ke pasë... na duhet me falenderu edhe diasporën se na ka ndihmu shumë, unë e kom pasë ni vlla edhe ai... tregova, ai ka qenë në fabrikë të procesit paimeve në “Trepçe”, ai u shku, se dikush u dufke me shku, dikush me metë këtu, me prindër, me këto... Ai vllau u shkue duhet me ja ditë për falemnderës gjithkush vllaznive, na kanë ndihmu aq sa ka pas mundësi. Se ata në fillim s’kanë punu, duhet me ju falenderu popullatën e Kosovës edhe Rrafshi Dukagjinit ka ndihmu në atë kohë shumë, edhe jom mirënjohës.

Kur u bo, tajshi që u bo sindikata thash pare, une kam qenë vëzhgus i sindikatës për lagjen Shipol. E kom pasë regjistrin e minatorëve, diku 107 a 108 minatorë veç në Shipol që jonë konë t’u banu. Tash emrat e tyne krejt i kom pasë edhe ndihmat që janë ardhë në Kosovë, që janë ardhë për minatorë të “Trepçës”, secila lagje e ka pasë numrin e vet. Shembull, unë i kom pasë njiqind minatorë, dikush i ka

pasë shembull, Shutkovci ose naj fshat ma i vogël 50, qysh i ke pasë minatorët numrin, qaq ke marrë ndihma edhe u duft me ja u çkep veç mos me shku me ra në dorë të armikut me punu për to.

Ka punu “Nënë Tereza” në Shipol, unë jom konë në kryesi të “Nënë Terezës” në Shipol, jom konë vëzhgues i minatorëve. Domethonë, këta kanë bashkëpunu bashkë sindikata e pavarun që u konë e minatorëve edhe “Nënë Terezë” në Shipol na kena bashkëpunu bashkë. Në një depo i kena lonë mjetet edhe ja u kena çkep punëtorëve. Domethonë, unë e kom pas regjistrin, ka ndodh kanë dhonë edhe pare, nashta shumë sasi të madhe, prej njëqind minatorëve, ndodhë dhjetë vetë që kanë qenë ma dobët ja u jep ka njëqind mark, atëherë janë konë. Po, rroba pune, ushqim, aksioni “Familja ndihmon familjen” u konë, unë jom kon i kyçun në qato rrjedha që çdo antarë që vjen me i majt “Familja ndihmon familjen”, u ardhë te une në Shipol edhe jom shku me to te iks personi, shembull.

Ka pasë, unë kom pasë kontakt edhe me njerëz ma... qetash mas lufte vonë, që e ka pasë ni anëtar, ni person i ka majtë 20 minatorë. Osht’ i Deçanit, 20 minatorë i ka majt, dy mijë mark, në atë kohë i ka dhonë çdo muj. Edhe rreziku ma i madhi u konë me i pru ko, se ai që i ka dhonë, që i ka dhonë ata, ai u konë jashtë, shiptari ma i pasun osht’, ka pasë në Amerikë... po e ka pasë mikun e vet këtu që e ka angazhu këto, “Ti ki me shku, me çu me ja u shkep”. Domethonë, muj e në muj ai i ka çkep dy mijë marka. Nashta edhe osht’ mirë me përmen ky Muharrem, Muharrem Gecaj, kem na edhe fotografi, jom konë në varrim të nonës tina. Muharrem Gecaj që u ardhë ju ka pru paret 20 minatorëve ja u ka çkep. Nifarë, nifarë libre ma ka dhonë dikun edhe e ka majt dikun në Shipol, dikun nashta ko në fshatra të Shalës, dikun në Drenicë, se ka pasë minatorë, domethonë, 20 minatorë i ka majt. Edhe ato na s’duhet me ja harru, se mos m’u konë qato nashta...

Ka pru ushqim, ka ndodhë e ka pre, e ka pre delmen ose dashin, gjysën ja ka pru vetit, gjysën e ka lonë për fëmi të vet. Edhe ka ndodhë, edhe mu më ka ndodh që i kom pasë punët shumë dobët materialisht. Edhe me cekë njo, u konë i Istogut, u konë Shaqa, veç më kujtohet Shaqë që e ka pasë emrin edhe ni familje me majt në Shipol. Po kur u ardhë ko në Shipol, ai ka thonë, vllaun e vet e ka pasë në Zvicër, këtij të Shipolit që osht’, i ka thonë, “Une të nimoj” se po don ni familje me majt, i ka thonë shko thuj, “Kur vjen ai me t’i pru paret, thuj që, ‘Merre ni familje tjetër dikun, faleminers shumë po merre dikun, se mu më ndihmon vllau jem, e ti nimoj tjetërkujt’”.

Edhe ai u ardhë, i ka thonë, “Jo, qishtu, jo unë erdha me t’i pru njëqind mark edhe merri knej”. E vjen më thotë mue, ai që e ka refuzu m’i marrë, jo ja ka refuzu, po s’ka pasë nevoj u konë polic. Se na kena punu edhe në “Nënë Terezë”. Se ndoshta nuk lidhet me minatorë, veç po du me ju tregu shembull. Edhe tash vjen ai thotë, “A po vini me mue edhe ti Gani” edhe njo që u konë i “Nënë Terezës” në Shipol edhe thotë, “shkojna edhe rrimë atje edhe ja spjegojna, i tregojna” thotë, “qysh o puna” thotë që, “vllau po don me më nimu”. Jena shku na me këtë personin, e kena marrë edhe nja dy vetë që jena konë të kryesisë, jena shkue në Istog e jena hi në odë, na kanë prit mirë.

I kena thonë, “Qishtu, qishtu o puna, faleminers prej teje që po i manë. Po vllavi i ka thonë, ‘Une i nimoj’, ti nimoj tjetërkujt” tha, “Pasha Zotin une nashta ma ligë se ti i kom punët, po kur ka fillu aksioni ‘Familja familjen’ na kanë mledhë” tha, “në Istog, unë jom konë ma i vjetri”. Thotë, “Edhe punët materialisht i kom... kurrfarë të ardhunash s’kom, po m’u ka duft mos m’u nda pi shoqnive” edhe thotë, “jom hi në qat’ aksion, faleminers prej juve”. Domethonë, na kena pasë asi raste që i kanë pasë shumë materialisht dobët punët, po e ka shpreh atë vullnetin me ju ndihmu minatorëve. Këta kanë ndihmu... po thom mu më ka ra rasti me shku te minatorët, ka pasë edhe profesora prej Prizereni, ka pasë edhe prej Dukagjini, domethonë krejt Kosova u solidarizu me neve, edhe kanë ndihmu, nashta kafshatën e gojës e ka nda përgjys. E qajo neve na ka nimu që na kena mujt m’u majtë, se me majtë pa paga familjen, me jetu u konë pak, pak vështirë.

Anita Susuri: Pastaj lufta kur ka vazhdu, domethonë në periudhën para luftës a keni qenë këtu ju?

Gani Osmani: Po. Une në luftë, po tregoj, në luftë, nuk kam qenë i veshur në luftë. Mirëpo, qajo lagja ku kena qenë na, osht’ afër Vakanicës edhe janë... ajo kasarnja e ushtrisë që ka qenë në Banj, domethonë na ka pa neve shumë, qysh thotë ni fjalë, si në pasqyre. Edhe nejse, do djem të axhës e këto jonë konë, po une nuk jom konë i kyçun se u dufke dikush mu konë i vetëm me familje e fëmijët e vogël, domethonë pleqtë e smutë, babën edhe nonën e kom pasë. Edhe me 15 prill neve na kanë rrethue, pi Baje janë lëshu edhe krejt Shipolit e kanë rrethu, e kanë pru ni ngushticë, domethonë na kanë qit te xhamia e Shipolit, me një rrugë shumë të ngushtë edhe na kanë qitë në rrugë të Pejës. Na kanë thonë, “Ju veç me vazhdu, na as vet s’kena ditë ku po shkojmë.

Une në atë kohë e kom pasë ni kësi kultivator, ni traktor të vogël si motokultivator. Edhe i kom ngarku une, i kom pasë katër fëmijë, i kom pasë katër fëmijë edhe nonën edhe babën. Nejse shoqen edhe ni motër e kom pasë te shpia, i kom pasë edhe katër musafirë. E kom pasë ni hallë, nejse çikën e motrës të babës u ardhë kështu me nejt te na pi qyteti, ajo u konë me çika edhe me ni djalë edhe i kom marrë, domethonë kur na ka rrethu policia me ta jom shkue 36 orë e kom të çkrume që e kom... me traktor kena bo edhe jena shku në Shipni. Domethonë, në qat’ kohën e luftës ka ndodhë, ka ndodhë që në qat’ kolonë që janë konë me neve, varet kush qysh, qysh je zatet në policë ose paramilitarë. Ka ndodhë qajo Vaganicë që osht’ ni fshat afër neve, me neve jonë konë familjarët, kur jena shku na në Gjurakovc, kanë thonë, “Nja 50 traktora duhet me hi për Gjurakovc”. E kanë ndërpre tajshi kolonën, tjerët me shku për Pejë, kush ka shku për Pejë ka pësuar keq.

Na i kem sot ka tre-katër janë të zhdukun të qatij fshati, në kolonë me neve, janë të zhdukun, i kanë vra, as kufomat s’ja kanë gjetë. U konë mas meje, na jena hi knena, fati kena pshtu. Domethonë, nuk, nuk u vra kërkush prej familjes, prej familjes tonë. Mirëpo, minatorët, na kem të vramë. Unë e kom edhe regjistrin si sindikalistë që kena... kem edhe të zhdukun, me emën, mbiemën që dikun 38 a 39 jonë të vramë, 15-16 janë të zhdukun. Ka edhe që jonë konë me uniformë të vramë, po ka edhe që jonë, jonë vra kështu në luftë si, si qytetarë.

Anita Susuri: E ju në Shipni, në cilën pjesë keni shku në cilin vend?

Gani Osmani: Po unë jom konë me ni pjesë... ma së pari jena shku në Kukës kena nejt pesë ditë, mirëpo i çojshin tajshi, ardhshin i çojshin nëpër pjesë, ma shumë i çojshin në Shipni në pjesën jugore anena nëpër depo, e nëpër qeso. Mirëpo, unë e kom pasë fëminë shumë të vogël, prej nonë muj dej domethonë, pesë-gjashtë vjet, gjashtë-shtatë vjet. Edhe pleqtë i kom pasë shumë të smutë edhe prej shtypje [të gjakut] edhe une jom shkue në Durrës kom nejt. Domethonë, jom hi në xhami të Durrësit kom nejt pesë ditë, prej atyhit jom shku ni kamp Porto Romano u thirrë, përtej Durrësi, nja pesë kilometra u konë. Aty ka pasë kamp spanjoll, italian, e gjerman. Domethonë, jom shku kom nejt në qat' kampin qaty. Ka pasë shumë popullatë. Domethonë, qaty dej në qershor kur u shlirue, që jonë hi forcat e NATO-s edhe masanej jena kthy masi janë hi forcat e NATO-s.

Anita Susuri: Qysh e keni kuptu që u shliku Kosova?

Gani Osmani: A? Po na... une po të kallxoj na kënaqësi ma të madhe, ma të madhe nashta s'kom ni kurrë. Domethonë, na e kena pasë, jo veç unë po çdokush e ka pas ondërr. Domethonë, edhe diqysh une për veti po thom mu m'u doke si e pabesushme për shembull me hi forcat e NATO-s. Fuqia ma e madhe e botës, nashta Kosova është si ni pikë uji në deti, a ni pikë në hartë me qitë, ka probleme ma të mëdha, mendimi jem është ky. Ka pasë probleme ma të mdhaja nëpër Evropë, e nëpër Ballkan e gjithka, po për herë të parë forcat e NATO-s me bombardu edhe me hi për Kosovën edhe na e kem ditë si janë hi forcat e NATO-s që kanë m'u shliku. Mirëpo, na nuk kem besu që edhe qeto masakra masi të hyjnë forcat kanë me ndodhë, une s'kom besu.

Na jena gëzu kur ka bombardu ma së pari në Prishtinë, na jena konë këtu që kanë bombardu edhe kur kanë bombardu në Bajr u konë kasarne shumë e madhe nëntokësore, ko gjamat te na jonë thy nëpër shpia tona, ko. Edhe na u kënaqëm diqysh, po na nuk i dishëm pasojat që po vijnë masanena. Ato une s'i kom mendu, as s'i kom mendu ato, as s'e kom mendu që, që ni forcë kaq e madhe, ni fuqi, ka me intervenu për, për Kosovën. Veç na duhet me ju falenderu Amerikës edhe Amerikës kryesore. Tajshi kjo i ka shti këto tjerat në fuqi. Amerikës duhet me ju falenderu edhe ndoshta çdo shpi e shiptarëve duhet me pasë ni flamur mrena, ni flamur amerikan. Mos m'u konë Amerika nashta ishim zhduk edhe prej këtij dheu, se na s'kem pasë forcë. Domethonë, Amerika na ka pshtu neve, falë edhe ushtrisë, tash edhe Ushtrisë Çlirimtare, aty duhet me ditë, po ushtria s'ka pasë forcë pa Amerikë, po edhe ushtrisë edhe popullatës se pa pasë vujtje as shtet e mdhaja nuk intervenojnë.

Anita Susuri: Mas luftës kur keni ardhë për herë të parë këtu, domethonë në objektin e "Trepçës"?

Gani Osmani: Shiqo, une, une kom menu pak ma ndrysh për "Trepçe". Na jena gut meniherë, se do ardhshin pak ma vonë, unë jom ardh meniherë si janë hi forcat e NATO-s, mas me thonë ni javë, katër-pesë ditë. Se thojsha, "Duhet me shku me ja nisë punës. E kom punën" thojsha, "në "Trepçe" si të shkojna krejt, çdo gja osht' në rregull". Thojsha, "Ko me ja nis punës edhe zhvillohet 'Trepça'".

Thashë, “Punojna për veti”. Po une kur jom ardh këtu, e kom pa pak ma ndryshe, shkatërrim. Shkatërrim, bile tash po du me lidh me njo në Shipni atje, na çojshin në do fabrika, në do... Thashë, “Qysh ja keni bo more fabrikave kështu?” I kishin shkatërru fabrikat. Tha, “Njejtë jem si na, si ju” tha, “vllazën jem” tha, “keni me pa, ju keni me ja bo edhe ma zi”. Edhe thash kena me ja nisë... Unë jam ardh prej 2000... 2004-tën ja kom nisë me punu.

Në 2000-tën, ja kanë nisë do përgaditje po edhe në “Trepçe” nuk o shku në rregull, se i kanë thirrë do nejrëz cik-cak, nashta jonë njerëz që kanë dhonë shumë kontribut edhe çka e ka meritu edhe çka e njeh punën, po u shku me të njofshëm. I kanë zgjedhë aty, “Jaran thirre me telefon njonin”. Në fillim u konë UNMIK-u në qat’ kohë, do pare ka pak ja u kanë dhonë, nihere jo, po dikur po. Kryesorja u konë me u kyç në punë. Atje fabrika e akumulatorëve elektroliza e zinkut. Çka jonë atje kompleksi i zinkut që është atje poshtë ku o bordi, krejt, çdo gja u konë në rregull, çdo gja u konë veç me ja nisë. Krejt u shkatërru, krejt e kanë... Atëherë shkijet s’e kanë shkatërru, po e kena shkatërru na vet.

Në 2004-tën na ka thirrë edhe po tregoj vet, na jena ardhë ni grup se jena konë si teknik, mbikëqyrës, e kena bo ni komision edhe jena ardhë kena thonë, “Po dojna me kërku punë ose kena me punu edhe na ose s’ka me punu kërkush”. Atëherë u konë Nazmi Mikullovc drejtor, edhe na kanë marrë njiqind vetë në qat’ kohë 2004-tën që jena punësu dyqind, njiqind vetë. Mirëpo, edhe me këta do, nji numër i qitën para kohe në pension. Thash, edhe në qeveri jom konë kom thonë, “Na kena menu që për minatorë ka me ndodh, nji gjo tjetër, jo qysh ka ndodh. Na kena menu që qeveria ka me u interesu për neve, se na jena konë ata njerëzit e parë që kem rreziku jetën, e kem mbrojt shtetin, u konë krejt Kosova mbrapa neve. Na kem menu njerëzit ça janë punëtorët e vjetër edhe që jonë të moshum e të smum qeveria ka me ja dhonë ni pension të dinjitetshëm, ni pension të mirë. Edhe m’i thonë, ‘Shko pi shpije, janë gjeneratat e reja, ke dhonë kontribut boll”.

Edhe nuk u konë numër me i marrë krejt 2300 minatorë që jonë konë pjesëmarrës të grevës, prej tyne po të garantoj dikun nja, ngat 500 kanë vdek, prej qatyne. Se do shumë të smutë, në atë kohë jonë konë edhe kohë e gatë qe 20 vjet. Nuk o numër i madh, unë thashë as nuk jom kundër ushtrie, as kundër veteranëve, po pe bon zgjidhjen për 60 mijë vetë e për nji mijë vetë nuk po mun me bo zgjidhje. Ka mujt me bo zgjidhjen e pensionit, me inkuadru njerëz, punëtorë të ri edhe me investu “Trepça”, me bo investime kapitale, m’u zhvillu. Po beso nëpër Mitrovicë me dalë ki pensionistë, pjesëmarrës të grevës nëpër konta të bërlllogut ka lypin kanaçe. Edhe nuk kanë pension të parakohshëm, jo i rregullt, 70-80 euro i merr penzion. Edhe të gjitha vujtjet edhe mundimet i ka kry, sot nëpër kanta të bërlllogut punojnë me kolica, i shtyjnë kolicat. E u duft, këto shteti u duft me rregullu po... unë thashë, kom mendu ndrysh e ndrysh...

Edhe tash 20 vjet mas lufte në “Trepçe” u duft me investu, me shti mjete qeveria, me marrë punëtorë të ri. Domethonë, kurgjo në “Trepçe” nuk o... këtu në “Trepçe” veç puno e merr qat’ rrogë, investim kurgjo, hin në borxh në tana anët, zhvillim në “Trepçe” nuk ka. “Trepça” ka mujt me zhvillu edhe Kosovën e jo vetveten, po sot për vetveten nuk mun e man, pagat nuk mun i bon prej koncentratit që e

shet. Ka mujt me i finalizu metalet që e shet veç plumb, zink, 30 minerale me vlerë që janë. Ni mini shkritore me bo... po e bon privatniku, po e bon pesë-gjashtë pompa të benzinës e bon firmë të veten, e bon... ni mini shkritore me bo, e m'i shkri këto e m'i shti të vet, jo... metalet nashta ma të pasne që janë këtu i merr Bullgaria, Zvicra, Suedia. Na e shesum koncentrat, ka ndodhë prej dy mijë dollarëve që u konë çmimi, ka ra në 300 dollarë. Me 300 dollarë janë shitë, aty ka ari, argjend, ka të gjitha.

U duft qeveria meniherë shkritoren edhe me punësu njerëz edhe me zhvillu shtetin. Po s'po ju intereson fort për "Trepçën", nuk po ju intereson. Unë e di ka deputet që kurrfarë informata për "Trepçën" nuk ka. A beson kur jom shku, kena bo kërkesa, qe kërkesat i kena të shkruje qitu {tregon me kokë djathtas} që mas lufte punojna në minierë në kushte qeto, e asnjë ditë përvojë pune nuk na njihet, thojke, "Qysh osht' e mundshme mos m'u njoft përvoja e punës në minierë?" Firmave private ja njeh përvojën e punës, neve s'na njeh. E ka që nuk jonë të informum edhe s'jonë të interesum.

Anita Susuri: Tash jeni edhe kryetar i sindikatës.

Gani Osmani: Po. Në 2016-tën, 2016 u ndrru sindikata, janë zgjidhjet e rregullta çdo katër vjet. Domethonë, 2016 na kena konkurue, domethonë, shkon në mënyrë të rregullt kjo sikur zgjidhjet komunale që bohen ose qëndrore prej baze çdo dhetë punëtorë shkon njo i delegum prej miniere, bohet kuvendi. Tajshi prej kuvendi zgjidhen edhe njimdhjetë antarë kryesia. 2016-tën na jem konë të zgjidhun prej punëtorëve edhe e kena bo kuvendin edhe prej kuvendit kam qenë në krye të sindikatës, në kryesi, jo kryetar po në kryesi kam qenë. Shyqyri Sadiku ka qenë kryetar i sindikatës, mirëpo Shyqa është edhe ekspert i prodhimit, domethonë i minierës edhe u deshtë me shku drejtor i prodhimit se kem ka shkojmë në kapitullim, nuk hecë prodhimi. Edhe tash edhe kryetar sindikate edhe drejtor prodhimi është një lloj konflikti i interesi, qysh me thonë. Edhe Shyqa ka thonë, "Unë po shkoj tre mujë po e provoj. Nëse më hec prodhimi hjekna prej sindikate edhe vazhdoni ju sindikatën".

Unë kam qenë sekretar i sindikatës. Shyqa ka shku, ka hecë dikun pi që shkun nontë mujorë 28 përqind u rrit prodhimi, prej që ka shku Shyqa në drejtor të prodhimit. Une kam qenë në kohë ushtrus detyre, qata dy-tru muj ushtrues detyrës i kryetarit të sindikatës, tash e kena majt në mledhje kryesia, qata që jem tash edhe më ka propozu Shyqa që dej në zgjedhjet e ardhshme me kry detyrën e kryetarit, unë m'u kon kryetar sindikate. Janë pajtu ata, është procesverbali në libër që e kena majt, kanë pajtue edhe kom vazhdu. Zgjidhjet na u duft m'i bo në fund, në fund të prillit të qetij viti. Mirëpo, ke qysh ke, na as mledhje s'kena mujt me majt shkaku i pandemisë e krejt. E kena majt mledhjen apet kryesia edhe e kena bo që qat' ditë që bohen kushtet për zgjedhje, na duhet me hi në zgjedhje në mënyrë të rregullt, kush fiton, fiton. Domethonë, jena tu e vazhdue në qat' mënyrë.

Na jena për mbrojtje të drejtave të punëtorëve, na vijnë punëtorët çka ju bohet e padrejtë prej drejtorave, prej këtyne i marrim me shkrim na çdo muj. E kena pasë me rregull me majt mledhjen e kryesisë e thirrëm edhe drejtorin gjeneral, poshtë kryeshefin edhe drejtorin këtu. Edhe kryesia e manë mledhjen edhe këto kërkesat e punëtorëve ja qesum përpara, qekjo, qekjo, qekjo edhe duhet, që ka

mundësi duhet m'u shqyrtu, se na ekzekutiv s'jem as me hek vendim, as me qit, mirëpo me i shty proceset përpara. Na kem edhe në qeveri i kom me shkrim edhe në Ministri të Zhvillimit Ekonomik, të gjitha ja kem çu me shkrim, që m'u kthy ka "Trepça", me njoft përvojën e punës, me dalë me një pension të dinjitetshëm, që osht' e mundshme m'u ndrru.

Nashta kem, kem na punëtorë diku 40-50 që jonë të smutë, nuk munët me punu në minierë rrinë në sipërfaqe. Na ato nuk mujm me i çu pi shpije, as me largu prej punës, ai prej qetuhit e ka fitu smundjen. Edhe në fund me bo ndrrim me ni fëmi tina, ky shkon... puna ato e shtin drejt në prodhim edhe jep kontribut. Edhe atë kërkesë ja kena bo, na kanë thonë që, "Po, pritum". Qetash u bo edhe ni bord i përkohshëm se na si viktimë jena ra, ndrrimi i qeverive. "Trepça" u ra viktimë, punëtorët, të ndrrimit të qeverive. Vjen ni qeveri të jep premtim që ka me, ka me punu për "Trepçe" e zgjedh nashta naj ekspert, nuk shkon pesë-gjashtë muj bjen, vjen tjetra duhet me ja nisë pi zeros. Domethonë, viktimë e këtyre qeverive ramë edhe na.

[Këtu ndërpritet intervista]

Anita Susuri: Ishit t'u më tregu për punëtorët që keni bo kërkesë me i ndrru me...

Gani Osmani: Po. Domethonë, prej mas lufte që ja kena nisë na me punu, kërkesat e njejta kanë qenë këto. Për shembull, qeto kërkesa. Na kem kërkuje me njoft penzionin, 70 përqind të pagës, ç'a është e drejtë e gjithkujna. Kem kërkuar njohjen, njohjen e stazhit të beneficum, stazhit jo të beneficum, po të stazhit që ka qenë i rregullt, domethonë kur na kanë qit pi punë na nuk kem qenë fajtorë tashi '89-'99. Edhe, edhe mas lufte, domethonë as mas lufte nuk na njihet prej 2018-ës e tekneja, nuk na njihet stazhi. Na çdo njoni që u hi... unë qe 39 vjet jom i punës, nesër me dalë në pension, dalë si papunë se nuk njihet, duhet m'i pasë ma së pakti 15 vjet përvojë pune edhe asnjë nuk i ka 15 vjet. Se shumë kohë e gatë, domethonë, kem kërkuje penzion familjar. Pensioni familjar gjithmonë ka qenë, vene të rrezikshme për miniera.

Na kem mas lufte katër raste tragjike në "Trepçe", dy në Kishnicë, dy i kena në "Trepçe". Domethonë, rast tragjik osht' kur vdes punëtori jo prej natyrës, po në vend të punës e nxen xeha ose mjetet e punës. Edhe përpara ka qenë penzioni familjar, familja e tij e ka trashëgu penzionin e tina 70 përqind edhe fëmija dej i ka bo 18 vjet ose gruja sa ka jetu e ka trashëgu pensionin, ajo u ndërpre. Kem kërku sigurim shëndetësor. Përpara kur u lëndu punëtori e kanë çu nëpër Ljublanë, e Shkup, e Beograd, e s'kanë lonë... tash mu më ka ndodh vet i kom çu punëtorët, e ka thy komën, u shku në shtëpi të shëndetit, ka thonë, "Në paç 20 euro e ngjet gipsin, s'paç shko ka të dush". Me mjete, me rroba të punës, me helmetë prej miniere u lëndu, domethonë si, si... të llogarit si njeri i papunë.

Tajshi i kem këto sigurimin shëndetësor, qajo sigurim shëndetësor, domethonë këto krejt i përfshin kontrata kolektive. Munët me bo ni kontratë kolektive edhe të gjithë këto, të gjitha këto i përfshin. Na e kena bo prej mas lufte e knej edhe sindikata përpara që u konë edhe tash të njejta kërkesa janë. Kjo

nuk osht' qaq punë e zorshme për qeveri, këto munën m'i kry, m'i kry të gjitha. Na kem lyp... na jem pak ma të veçantë se njësitë tjera, neve s'munën me na krahasu nashta edhe, edhe KEK-u janë minatorë edhe ata pak nxjerrin qymyr e bojnë, mirëpo aty gërryn eskallatori ai veç kqyr. Domethonë, na jem, na e marrum... na punojmë nëntokë, e kush punon mbi tokë nuk munëm m'u krahasu. Ka mujt qeveria ni ligj të veçantë për minatorë edhe m'i mbyll të gjitha këto. Mirëpo, me punën e qeverisë për "Trepçën" po të tregoj si sindikalist nuk jom i knaqun. Edhe jo veç me qit qeveri, po çdo qeveri që u ardhë na ka anashkalu.

Tash na të gjithë shpresat i kem që kem me hecë përpara. "Trepça" ka qenë shtylla e tretë në Jugosllavinë e 22 milion banorëve, një nga shtyllat ma të mdhaja ekonomike. Që shteti ka marrë kredi në emër të "Trepçës" e ka majtë... edhe parulla atëherë u konë "'Trepça' punon, Beogradi ndërton". Kurse, sot në durë tona osht' nuk jem në gjendje na pagat e minatorëve me i... Mendim i jemi osht' që qeveria me e kthy kryet ka "Trepça", me bo investime kapitale, mjete të punës edhe munët me zhvillu jo vetëm "Trepçën", po munët me zhvillu edhe Kosovën. E jo na m'u konë... minatorët me pasë gajle a po i bohet... qat' telashe e ka, besom që mu në telefon më thirrin, "A ka pare për rrogë, a bohet rroga?" Nuk e ka gajle ai që e ka punën e vështirë atje. Planin e qet, punën e kryen, e ka telashe a ka me marrë rrogën qet muj, a s'ka me marrë. Domethonë, do telashe që munët shteti me i zgjidh.

Anita Susuri: Nëse keni edhe diçka me shtu, nëse keni harru me përmend?

Gani Osmani: Une nuk kisha me shtu kurgjo, veç apet ni apel për qeverinë, për njerëz që janë kompetent ne te kthejnë kryt ka "Trepça", ka zhvillimi ekonomik, se "Trepça" e zhvillon Kosovën, e zhvillon Mitrovicën, e zhvillon domethonë krejt popullin shiptarë. Le të marrin punëtorë të ri, le të bojnë investime kapitale edhe hecum përpara. Mos t'i bohëm na lëmoshë e kërkujna. Le të bojnë... munën me bo finalizimin e xehes këtu, jo me i çu jashtë, qajo osht' kapitali ma i madhi domethonë. Une tjetër s'kisha me shtu veç dhashtë Zoti që do të bohet ma mirë edhe do ta kthej kryt dikush ka "Trepça".

Anita Susuri: Shpresojmë edhe na. Faleminderit shumë zoti Gani!

Gani Osmani: Falemnderit prej juve edhe për interesimin!